Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008), bazuar në nenin 81 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068, Ligjin Nr.05/L-092, bazuar në Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja, shqyrtoj kërkesën e datës 17.10.2022 përmes emalit zyrtar të parashtruar nga Agjencisë Qendrore e Prokurimit të pranuar nga Drejtoria për Administratë Komunale të datës 19.10.2022, për caktimin e Menaxherit të kontratës dhe Mbikëqyrësit të drejtpërdrejt të Menaxherit të kontratës për projektin: “Furnizim me goma dimërore për automjetet”; nxjerr:

V E N D I M

- 1. ÇAKTOHET:** Menaxher i kontratës **z.Bashkim Haxhiaj**, Zyrtar për Transport 1 dhe Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës **ÇAKTOHET: z.Arben Kabashi**, Drejtor i Drejtorisë për Administratë Komunale, për projektin: “Furnizim me goma dimërore për automjetet”, me numër të jashtëm prokurimi AQP-22-010-111 dhe me numër të brendshëm prokurimi UA/2016-22-5365-1-1-1, të cilin projekt e ka fituar Grup i operatoreve Ekonomik **“GOMA PRO”SH.P.K &BI TERM SH.P.K.**
2. Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të kontratës obligohet që të bëjë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës duke zbatuar nenin 61 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01, si dhe Manualët për Përdorim të Modullit për Menaxhim të Kontratës.
3. Përgjegjësin për realizimin e projektit të lartcekur e marr Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të kontratës.
4. Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit dhe fillon të zbatohet menjëherë.
5. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- z.Bashkim Haxhiaj, Menaxher i kontratës,
- z.Arben Kabashi, Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj. Zekije SUTAJ




	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		
Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	Nr.Br.01-792/2022	Data: Datum: 21.10.2022	Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008), bazuar në nenin 81 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068, Ligjin Nr.05/L-092, bazuar në Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja, shqyrtoj kërkesën e Prokurimit të datës 13.10.2022, të pranuar nga Drejtoria për Shëndetësi me datë 20.10.2022 për caktimin e Menaxherit të kontratës dhe Mbikëqyrësit të drejtpërdrejt të Menaxherit të kontratës për projektet: Lot1 "Furnizimi me uniforma për staf të Komunës, të QKMF-së dhe të DKA-së"; Lot2 "Furnizimi me veshmbathje për rezident në shtëpinë për Komunitete" në Gjurakoc, nxjerr:

V E N D I M

1. CAKTOHET: Menaxheri i kontratës **znj.Merita Bytyçi**, Drejtoria për Mirëqenie Sociale, për projektin: Lot1 "Furnizimi me uniforma për staf të Komunës, të QKMF-së dhe të DKA-së"; **CAKTOHET:** Menaxheri i kontratës **znj.Arlinda Demaj**, Zyrtare për regjistrimin e pasurisë në QKMF, në Istog, për projektin: Lot2 "Furnizimi me veshmbathje për rezident në shtëpinë për Komunitete në Gurakoc; me numër të jashtëm prokurimi 633-022-8699-1-2-1/C622 dhe me numër të brendshëm prokurimi 633-022-060-121. Mbikëqyrës i drejtpërdrejt i Menaxherëve të kontratave **CAKTOHET:** **z.Zenel Shatri**, Drejtorë i Drejtorisë për Shëndetësi, të cilin projekt me Lot 1 e ka fituar për ta realizuar operatori ekonomik **N.P.T "PRINTEKS"** nga Prizreni dhe projektin me Lot 2 e ka fituar për ta realizuar operatori ekonomik **"SANKOS" SH.P.K** nga Kaçaniku.

2. Menaxheret e kontratave dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherëve të kontratave obligohen që të bëjë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratave duke zbatuar nenin 61 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01, si dhe Manualin për Përdorim të Modullit për Menaxhim të Kontratës.

3. Përgjegjësin për realizimin e projekteve të lartcekur e marrin Menaxheret e kontratave dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherëve të kontratave.

4. Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

5. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- znj.Merita Bytyçi,
- znj.Arlinda Demaj,
- z.Zenel Shatri dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj. Zekije SUTAJ




**Kryetari Komunës-ZKA
z.Illir FERATI**


 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-793/022	Data: Datum: 21.10.2022	

Kryetari i Komunës duke u bazuar në nenin 58, pika h) e Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 68, paragrafi 68.1, pika 8 e Statutit të Komunës 01 Numër 62/10 të datës 30.11.2010, për anulimin e taksës nga neni 11 paragrafi 1 nenparagrafi 1.1 i Rregullores për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha të vitit 2021 dhe Kuvendit të Komunës i:

P R O P O Z O N

Kuvendit të Komunës, që në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, dhe Statutin e Komunës 01 Numër 62/10 të datës 30.11.2010, në mbledhjen e mbajtur me datë .10.2022 të merr këtë:

V E N D I M PËR ANULIMIN E TAKSËS PËR VLERËSIMIN E DËMEVE NË BUJQËSI DHE PYLLTARI NË SHUMË PREJ 10 €

1. Të **MIRATOJË** anulimin e taksës për vlerësimi e dëmeve në Bujqësi dhe Pylltari sipas neni 11 paragrafi 1 nenparagrafi 1.1 i Rregullores për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha të vitit 2021.

2. Qëllimi i anulimit të kësaj takse për vlerësimin e dëmeve në Bujqësi dhe Pylltari në shumë prej 10€ është që ti liroj fermerët nga kjo taksë, pasi që ata janë të dëmtuar nga demi që i'u është shkaktuar dhe në shumë raste nuk po kemi mundësi ti kompensojmë dëmet e tyre, dhe po shkaktohet ngarkesë që të paguajnë edhe këtë taksë.

2. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe HJidroekonomi.

3. Ky Vendim hynë në fuqi pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës, dërgimit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal-MAPL, siç është përcaktuar në nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 17 të Rregullores Nr. 02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimit të Akteve të Komunës dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose në ueb faqen e Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Kuvendit të Komunës,
- Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe HJidroekonomi dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ



Kryetari Komunës
z.Illir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-795/022	Data: Datum: 24.10.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe nenit 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 8 paragrafi 3, nën paragrafi 3.2 të Rregullores MF-NR-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, dhe në nenin 69 paragrafi 4 i Statutit të komunës 01.Nr.62/2020 i miratuar me datë 30.11.2010, shqyrtoj kërkesën 02 Nr.57/2022 të datës 24.10.2022, të parashtruar nga Drejtoria për Administratë Komunale për anulimin e thirrjes publike të datës 04.10.2022 për projektin: "16 ditët e aktivizimit kundër dhunës në familje", për shkak të mos përzgjedhjes së dy anëtarëve të jashtëm, në cilësinë e ekspertëve në Komisionin Vlerësues, nxjerr:

V E N D I M

- 1.SHFUQIZOHET:** Vendimi 01Nr.720/2022 i datës 29.09.2022 për shpalljen e thirrjes publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve dhe programeve të OJQ-ve.
- 2. Anulohet thirrja publike** e datë 04.10.2022 për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve dhe programeve të OJQ-ve. Drejtoria për Administratë Komunale për shkak të mos përzgjedhjes së dy anëtarëve të jashtëm, në cilësinë e ekspertëve në Komisionin Vlerësues, i ka rekomanduar Kryetarit për anulim.
- Vendimi 01Nr.350/2022 i datës 25.05.2022, nuk është në fuqi nga data 24.10.2022.
- Obligohet Drejtoria për Administratë Komunale që të **Rishpallë thirrjen publike me datën 25.10.2022.**
- Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për realizimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Administratë Komunale..
- Vendimi është përfundimtarë.

Vendimi i dërgohet:

- Drejtorisë për Administratë Komunale dhe
- Arkivin e zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KUVENDI I KOMUNËS SKUPŠTINA OPŠTINE MUNICIPAL ASSEMBLY		 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
	Nr.Br.01-795 /2022	Data: Datum: 24.10.2022	

Predsednik opštine, na osnovu člana 13 i člana 58 tačka b), Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi, (Službeni list Republike Kosovo br. 28/2008), u čl. 8 stav 3 pod stav 3.2 Uredbe MF-NR-04/2017 o kriterijumima, standardima i procedurama javnog finansiranja NVO-a i članom 69 stav 4 Statuta opštine 01.br.62/ 2020, odobren od 30.11.2010 godine, razmatran zahtev 02 br.57/2022 od 24.10.2022 godine, koji je podnela Direkcija za opštinsku administraciju, za poništenje javnog poziva od 04.10.2022 godine za projekat: „16 dana aktivacije protiv nasilja u porodici“, zbog ne izabira dva eksterna člana, u svojstvu stručnjaka, u Komisiju za ocenjivanje, donese ovu:


O D L U K U

1. **PONIŠTENO:** Odluka 01 br. 720/2022 od 29.09.2022 godine za raspisivanje javnog poziva za pružanje javne finansijske podrške, finansiranje projekata i programa NVO.
2. **Poništava se javni poziv** od 04.10.2022 godine za pružanje javne finansijske podrške, za finansiranje projekata i programa NVO-a. Direkcija za opštinsku administraciju zbog ne izbora dva eksterna člana, u svojstvu stručnjaka u komisiji za ocenjivanje, preporučila Predsedniku opštine za poništenje.
3. Odluka 01 br. 350/2022 od 25.05.2022 godine nije na snazi od 24.10.2022.
4. Direkcija za opštinsku administraciju je dužna **da ponovo raspiše javni poziv dana 25.10.2022.**
5. Ova Odluka stupa na snagu odmah po potpisivanju, a o njenom sprovođenju staraće se: Direkcija za opštinsku administraciju.
6. Odluka je konačna.

Odluka se šalje:

- Direkciji za opštinsku administraciju i
- Arhivi kabineta predsednika.

Rukovodilac pravnog sektora
gđa. Zekije SUTAJ



Predsednik Opštine
g. Ilir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-796/2022	Data: Datum: 24.10.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 46, 47. dhe 48. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Drejtoria për Shëndetësi, shqyrtoi kërkesën Nr.06-553-45460, të datës 20.10.2022, të parashtruar nga z.Fatmir Hajzeraj, nga fsh.Uçë, Komuna e Istogut, për përkrahje me karburant për dërgimin e bashkëshortes se tij në QKUK në Prishtinë dhe i propozon Kryetarit të nxjerri:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.06-553-45460, të datës 20.10.2022, e parashtruar nga z.Fatmir Hajzeraj, për përkrahje me karburant për dërgimin e bashkëshortes në QKUK - Prishtinë për marrjen e terapisë mjekësore, dhe i lejohen 100 litra karburant për 10 seanca, sipas raportit të mjekut specialist në QKUK.
2. Parashtruesi i kërkesës: z.Fatmir Hajzeraj, obligohet që pas perfundimit të seances se 10, ti sjellë raportet e mjekut për vizitat e realizuara, në te kunderten i nderpritet furnizimi i metutjeshëm
3. Obligohet Shefi i autoparkut që të pajisë z.Fatmir Hajzeraj, me vërtetim për furnizim me karburant të automjetit, në sasinë e cekur në pikën 1. të këtij Vendimi, në pajtim me procedurat të cilat vlejné për furnizim me karburant të automjeteve zyrtare, nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi.
4. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi dhe Shefi i autoparkut.
5. Vendimi është përfundimtarë.

A r s y e t i m

z.Fatmir Hajzeraj, ka parashtruar kërkesën Nr.06-553-45460, të datës 20.10.2022, me të cilën ka kërkuar që t'i mundësohet furnizimi me karburant për automjetin më të cilin bëhet transportimi i saj. Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurës dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton. Nga kërkesa e parashtruar dhe raportet mjekësore shihet se znj.Mihane Hajzeraj, është e sëmurë dhe i ndihmohet me karburant për mbushjen e veturës për dërgimin e saj për marrjen e terapisë në QKUK në Prishtinë.

I lartpërmenduri nuk e ka gjendjen ekonomiko sociale të mirë dhe nuk ka mundësi familja me i bartë të gjitha shpenzimet e transportit për dërgimin e saj për në Prishtinë për marrjen e terapisë.

Shefi i autoparkut do të pajisë të përmendurën më vërtetim për furnizim me karburant nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi në pajtim me procedurat që vlejné edhe për automjetet zyrtare.

Drejtorja për Shëndetësi do të kujdeset që të bëhet furnizimi i automjetit me karburant dhe do të përcjellë realizimin e këtij Vendimi.

Për sa u tha me lartë u vendos si në diapozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: z.Fatmir Hajzeraj, Drejtoria për Shëndetësi, Shefi i autoparkut dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 znj.Zekije SUTAJ




 Kryetari i Komunës
 Ilir FERATI


 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01- 797/022	Data: Datum: 24.10.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar ne nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), ne nenin 46, 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Komisioni për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare, shqyrtoi kërkesën 06 Nr.553-23542 të datës 10.06.2022 të parashtruar nga z.Florian Haxhiu, nga f.sh Raksosh, Komuna e Istogut për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërim, dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa 06 Nr.553-23542, e datës 10.06.2022 e parashtruar nga z.Florian Haxhiu, për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërim dhe me propozim të Komisionit i ndahen mjete financiare në shumë prej **300.00€ (treqind euro)** nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i zyrës së kryetarit, si ndihmë momentale për shërim.
2. Mjetet e cekura do të transferohen në xhirollogarinë e z.Florian Haxhiu në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësisë.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

z.Florian Haxhiu, ka parashtruar kërkesën 06 Nr.553-23542, të datës 10.06.2022, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për blerjen e terapisë për shërim.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Nga shkresat e parashtruara dhe raportet e mjekëve shihet se z.Florian Haxhiu, është i sëmurë dhe si pasojë e kësaj ka nevojë për blerjen e terapisë të cilat janë mjaftë të kushtueshme.

I përmenduri është në gjendje jo të mirë ekonomike dhe nuk ka asnjë burim të rregullt të të ardhurave dhe kjo i pamundëson që me mjete vetanake të bëjë blerjen e terapisë për shërim dhe në mungesë të mjeteve financiare përkrahet vetëm në shumë prej **300.00€ (treqind euro)**.

Në plan programin buxhetor të Zyrës së Kryetarit, është përcaktuar edhe pozicioni subvencione dhe transfere, mjete nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale për shërim.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e tij në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Florian Haxhiu,
- Drejtorisë për Shëndetësi dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 znj.Zekije SUTAJ




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-798/022	Data: Datum: 25.10.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 21 të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, nenin 11 paragrafi 5 dhe paragrafi 6 nënparagrafi 6.1,6.2,6.3 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civil, shqyrtoj kërkesën 00Nr.138/2022 të datës 14.10.2022, të parashtruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, për kompensim për punë jashtë orari për znj.Vjosa Hysenaj, Zyrtare e Lartë për Punë profe ionale të Kuvendi të Komunës, nxjerri:

V E N D I M

1.MIRATOHET: kërkesa 00Nr.138/2022 e datës 14.10.2022, e parashtruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, për kompensimin për punë jashtë orarit të punës, ditëve të vikendit dhe gjatë festave zyrtare për **znj.Vjosa Hysenaj**, Zyrtare e Lartë për Punë Profesionale të Kuvendi të Komunës,

2. znj.Vjosa Hysenaj për punë jashtë orari të punës për 48 orë pune me 30% kompensohet në shumë prej 176.64€(njëqind e shtëdhjetë e gjashtë euro e gjashtëdhjetë e katër cent); për 10 orë pune me 50% ditëve të vikendit kompensohet në shumë prej 42.40€ (katërdhjetë e dy euro e katër dhjet cent); për 8 orë pune kompensohet me 100% ditëve të festave zyrtare në shumë prej 45.28 (katerdhjetë e pesë euro e 28 cent), e që gjithsejtë në shumë të përgjithshme **221.92€ (dyqind e njëzet e dy euro e nëntëdhjetë e dy cent).**

2.Mjetet e përcaktuara, në pikën 1. të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e znj.Vjosa Hysenaj, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave publike dhe të përgjegjësi.

3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Kryesuesi i Kuvendit të Komunë dhe Zyrtarja Financiare për paga Mëditje dhe Kompensime.

4.Vendimi është përfundimtarë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- znj.Vjosa Hysenaj,
- Kryesuesit të Kuvendi të Komunës,
- Emina Coković, Zyrtare Financiare për paga Mëditje dhe Kompensime dhe
- Arkivin e zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ



Kryetari Komunës
z.Illir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01- 799/022	Data: Datum: 25.10.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 46, 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nën 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Komisioni për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare, shqyrtoi kërkesën 06 Nr.553-21613 të datës 01.06.2022 të parashtruar nga z.Luan Qetaj, nga f.sh Trubuhoc, Komuna e Istogut për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërim, dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa 06 Nr.553-21613, e datës 01.06.2022 e parashtruar nga z.Luan Qetaj, për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërim dhe me propozim të Komisionit i ndahen mjete financiare në shumë prej **150.00€ (njeqindpesedhjetë euro)** nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i zyrës së kryetarit, si ndihmë momentale për shërim.
2. Mjetet e cekura do të transferohen në xhirollogarinë e z.Luan Qetaj në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësisë.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

z.Luan Qetaj, ka parashtruar kërkesën 06 Nr.553-21613, të datës 01.06.2022, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për blerjen e terapisë për shërim.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Nga shkresat e parashtruara dhe raportet e mjekëve shihet se z.Luan Qetaj, është i sëmurë dhe si pasojë e kësaj ka nevojë për blerjen e terapisë të cilat janë mjaftë të kushtueshme.

I përmenduri është në gjendje jo të mirë ekonomike dhe nuk ka asnjë burim të rregullt të të ardhurave dhe kjo i pamundëson që me mjete vetanake të bëjë blerjen e terapinë për shërim dhe në mungesë të mjeteve financiare përkrahjet vetëm në shumë prej **150.00€ (njeqindpesedhjetë euro)**.

Në plan programin buxhetor të Zyrës së Kryetarit, është përcaktuar edhe pozicioni subvencione dhe transfere, mjete nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale për shërim.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e tij në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Luan Qetaj,
- Drejtorisë për Shëndetësi dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 znj.Zekije SUTAJ




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-800/022	Data: Datum: 25.10.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar ne nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), ne nenin 46, 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Komisioni për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare, shqyrtoi kërkesën, 06 Nr.553-45931 të datës 24.10.2022, të parashtruar nga znj.Bahtije Qiriri, nga fsh.Tomoc, Komuna e Istogut për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërim, dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa 06 Nr.553-45931 e datës 24.10.2022 e parashtruar nga znj.Bahtije Qiriri, për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërim dhe me propozim të Komisionit i ndahen mjete financiare në shumë prej **100.00€ (njëqind euro)** nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi, si ndihmë momentale për shërim.
2. Mjetet e cekura do të transferohen në xhirollogarinë e znj.Bahtije Qiriri, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësisë.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

znj.Bahtije Qiriri, ka parashtruar kërkesën 06 Nr.553-45931, të datës 24.10.2022, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për blerjen e terapisë për shërim.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Nga shkresat e parashtruara dhe raportet e mjekëve shihet se znj.Bahtije Qiriri është e sëmurë dhe si pasojë e kësaj ka nevojë për blerjen e terapisë të cilat janë mjaft të kushtueshme.

E përmendura është në gjendje jo të mirë ekonomike dhe nuk ka asnjë burim të rregullt të të ardhurave dhe kjo i pamundëson që me mjete vetanake të bëjë blerjen e terapisë për shërim dhe në mungesë të mjeteve financiare përkrahet vetëm në shumë prej **100.00€ (njëqind euro)**.

Në plan programin buxhetor të Drejtorisë për Shëndetësi, është përcaktuar edhe pozicioni subvencione dhe transfere, mjete nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale për shërim.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e tij në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Bahtije Qiriri,
- Drejtorisë për Shëndetësi dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 znj.Zekije SUTAJ




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-801/022	Data: Datum: 25.10.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 21 të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, nenin 11 paragrafi 5 dhe paragrafi 6 nënparagrafi 6.1,6.2,6.3 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civil, shqyrtoj kërkesën 00Nr.138/2022 të datës 14.10.2022, të parashtruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, për kompensim për punë jashtë orari për z. Blerim Gerguri, Zyrtar për Përkthim, nxjerri:

V E N D I M

1.MIRATOHET: kërkesa 00Nr.138/2022 e datës 14.10.2022, e parashtruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, për kompensimin për punë jashtë orari të punës, ditëve të vikendit dhe gjatë festave zyrtare për z.Blerim Gerguri, Zyrtar për Përkthim.

2. z.Blerim Gerguri, për punë jashtë orari të punës për 20 orë pune me 30% kompensohet në shumë prej 73.00€(shtatëdhjetë e tri euro); për 10 orë pune me 50% ditëve të vikendit kompensohet në shumë prej 42.20€ (katërdhjetë e dy euro e njëzet cent); për 8 orë pune kompensohet me 100% ditëve të festave zyrtare në shumë prej 44.96 (katërdhjetë e katër euro e nëntëdhjetë e gjashtë cent), e që gjithsejtë në shumë të përgjithshme **160.16€ (njëqind e gjashtëdhjetë euro e gjashtëmbëdhjetë cent).**

2.Mjetet e përcaktuara, në pikën 1. të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e z.Blerim Gerguri, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave publike dhe të përgjegjësive.

3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Kuvendi i Komunës dhe Zyrtarja Financiare për paga Mëditje dhe Kompensime.

4.Vendimi është përfundimtarë

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapë konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- z.Blerim Gerguri,
- Kuvendi i Komunës,
- Emina Coković, Zyrtare Financiare për paga Mëditje dhe Kompensime dhe
- Arkivin e zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ



Kryetari Komunës
z.Illir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-802/022	Data: Datum: 25.10.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 21 të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, nenin 11 paragrafi 5 dhe paragrafi 6 nënparagrafi 6.1,6.2,6.3 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civil, shqyrtoj kërkesën 00Nr.138/2022 të datës 14.10.2022, të parashtruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, për kompensim për punë jashtë orari për z.Mehmed Ćeman, Zyrtar për Përkthim, nxjerri:

V E N D I M

1.MIRATOHET: kërkesa 00Nr.138/2022 e datës 14.10.2022, e parashtruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës; për kompensimin për punë jashtë orari të punës, ditëve të vikendit dhe gjatë festave zyrtare për z.Mehmed Ćeman, Zyrtar për Përkthim.

2. z.Mehmed Ćeman, për punë jashtë orari të punës për 20 orë pune me 30% kompensohet në shumë prej 71.00€(shtatëdhjetë e një euro); për 10 orë pune me 50% ditëve të vikendit kompensohet në shumë prej 41.25€ (katërdhjetë e një euro e njëzet e pesë cent); për 8 orë pune kompensohet me 100% ditëve të festave zyrtare në shumë prej 44.00€ (katerdhjetë e katër euro), e që gjithsejtë në shumë të përgjithshme **156.85€ (njëqind e pesëdhjetë e gjashtë euro e tetëdhjetë e pesë cent).**

2.Mjetet e përcaktuara, në pikën 1. të këtij Vendimi, do të transferohen në shirollogarinë e z.Mehmed Ćeman, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave publike dhe të përgjegjësi.

3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset Kuvendi i Komunë dhe Zyrtarja Financiare për paga Mëditje dhe Kompensime.

4.Vendimi është përfundimtarë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet;

- z.Mehmed Ćeman,,
- Kuvendi i Komunës,
- Emina Coković, Zyrtare Financiare për paga Mëditje dhe Kompensime dhe
- Arkivin e zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ

[Signature]

Kryetari Komunës
z.Illir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-803/022	Data: Datum: 25.10.2022	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008) dhe bazuar në nenin 69 paragrafi 4 të Statutit të Komunës 01 Nr.62/-010 të miratuar me datën 30.11.2010, shqyrtoj kërkesën e Drejtorisë Komunale për Arsim të datës 25.10.2022 për formim të komisionit për verifikimin e punëve për projektin: Lot1“Instalimi i Kamerave ne Institucionet Shkollore te Komunës se Istogut” me numër të jashtëm prokurimi 633-21-4820-1-2-1/ C570 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-021-043-121 dhe nxjerr:

V E N D I M

1. FORMOHET: Komisioni për verifikimin e punëve për projektin: Lot1“Instalimi i Kamerave ne Institucionet Shkollore te Komunës se Istogut” me numër të jashtëm prokurimi 633-21-4820-1-2-1/ C570 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-021-043-121 të cilin e ka realizuar Grupi i operatorëve N.T.SH. “NODE TECH & EKoN SH.P.K”, dhe në komision caktohen:

- 1.1. **Agron Zeqiraj**, Mësimdhënës IT në shkollën “Bajram Curri” në Istog , Kryesues i Komisionit,
- 1.2. **Fazli Alihajdaraj**, Mësimdhënës IT në shkollën“Tre Dëshmoret” në Uçë, anëtar,
- 1.3. **Resul Kovoqeviq**, Koordinator.

2. Komisioni do të bëjë kontrollimin e tërë dokumentacionit dhe realizimin teknik të projektit të cekur në pikën 1. të këtij Vendimi, sipas projektit detal ekzekutiv; do të njoftojë kryerësin e punëve me të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet sa i përket kryerjës së punimeve; do të njoftoj menaxherin e kontratë dhe mbikëqyrësin e drejtpërdrejt të menaxherit të kontratës, do të njoftojë Kryetarin lidhur me realizimin punimeve për projektin e lartcekur; do të hartojë procesverbalin për verifikimin e punimeve si dhe do t'i kryejë punët dhe detyrat tjera që kanë të bëjnë me natyrën e këtij komisioni.

3. Përgjegjësin për verifikimin e punëve për projektin e lartcekur e merr Komisioni ndërsa menaxheri i kontratë dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejt të menaxherit të kontratës, merr përgjegjësin për realizimin e punëve të këtij projekti.

4. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Komisioni dhe Drejtoria Komunale për Arsim.

5. Vendimi është perfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit,
- Prokurimit,
- Drejtorisë Komunale për Arsim dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ



Kryetari Komunës
z.Illir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-804/2022	Data: Datum: 25.10.2022	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në nenin 59 paragrafi 1 i Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.18/2011), në nenin 40 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja, shqyrtoj kërkesën e Prokurimit të datës 24.10.2022, për themelimin e Komisionit vlerësues të tenderit për projektin: Lot1 "Furnizimi me inventar të qerdhës në Vrellë", Lot2 "Furnizim me inventar për nevoja të shtëpisë se komuniteteve, QKMF-së dhe Administratës Komunale", me numër të jashtëm prokurimi 633-022-10762-1-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-22-072-121, nxjerr:

V E N D I M

1.THEMELOHET: Komisioni vlerësues i tenderit për projektin: Lot1 "Furnizimi me inventar të qerdhës në Vrellë", Lot2 "Furnizim me inventar për nevoja të shtëpisë se komuniteteve, QKMF-së dhe Administratës Komunale", me numër të jashtëm prokurimi 633-022-10762-1-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-22-072-121, dhe në komision caktohen

- 1.1. Fisnik Shoshaj,** Zyrtar Ligjor2, Kryesues i Komisionit,
- 1.2. Mirëjeta Beqiraj,** Drejtoreshë e Qerdhës "Lulet e Jetës", anëtare dhe
- 1.3. Agim Pacaj,** Zyrtar për Shërbim me Qytetar, anëtar.

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në pajtim me kriteret e specifikuar në dosjen e tenderit: Lot1 "Furnizimi me inventar të qerdhës në Vrellë", Lot2 "Furnizim me inventar për nevoja të shtëpisë se komuniteteve, QKMF-së dhe Administratës Komunale", me qëllim të konstatimit të tenderit të vlerësuar si me i miri si dhe do t'i kryejë të gjitha punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Të gjithë anëtarët e komisionit i nënshtrohen rreptësisht dispozitave të nenit 11 të LPP-së në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete të ofertave.

4. Anëtarët e komisionit vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin teknik të ofertës sipas nenit 40 paragrafi 40.3 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja.

5. Zyrtari përgjegjës i prokurimit do të organizoj, këshilloj dhe drejtoj punën e Komisionit vlerësues dhe do të siguroj respektimin e dispozitave të LPP-së dhe Rregullave të Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja.

6. Obligohen anëtarët e komisionit që në afatin me të shkurtër kohor të prezantojnë pranë zyrës se Prokurimit dhe Prokurimi t'u ofroj qasje në ofertave që kanë shprehur konkurrencë.

7. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisioni, Prokurimi, Drejtoria Komunale për Arsim, Drejtoria për Shëndetësi dhe Drejtoria për Administratë Komunale.

8. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit,
- Prokurimit,
- Drejtorisë Komunale për Arsim,
- Drejtorisë për Shëndetësi,
- Drejtorisë për Administratë Komunale dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-805/2022	Data: Datum: 25.10.2022	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në nenin 59 paragrafi 1 i Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.18/2011), në nenin 40 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja, shqyrtoj kërkesën e Prokurimit të datës 24.10.2022, për themelimin e Komisionit vlerësues të tenderit për projektin: “Mirëmbajta e Adresave”, me numër të jashtëm prokurimi 633-022-10987-1-3-6 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-22-077-136, nxjerr:

V E N D I M

1.THEMELOHET: Komisioni vlerësues i tenderit për projektin: “Mirëmbajta e Adresave”, me numër të jashtëm prokurimi 633-022-10987-1-3-6 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-22-077-136, dhe në komision caktohen

- 1.1. **Berat Hasanaj**, Zyrtar për Shërbim me Qytetar, Kryesues i Komisionit,
- 1.2. **Gazmend Sadriaj**, Zyrtar Ligjor, anëtar dhe
- 1.3. **Shefqet Imeraj**, Zyrtar i Prokurimit2, anëtar.

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në pajtim me kriteret e specifikuar në dosjen e tenderit: “Mirëmbajta e Adresave”, me qëllim të konstatimit të tenderit të vlerësuar si me i miri si dhe do t’i kryejë të gjitha punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Të gjithë anëtarët e komisionit i nënshtrohen rreptësisht dispozitave të nenit 11 të LPP-së në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete të ofertave.

4. Anëtarët e komisionit vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin teknik të ofertës sipas nenit 40 paragrafi 40.3 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja.

5. Zyrtari përgjegjës i prokurimit do të organizoj, këshilloj dhe drejtoj punën e Komisionit vlerësues dhe do të siguroj respektimin e dispozitave të LPP-së dhe Rregullave të Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja.

6. Obligohen anëtarët e komisionit që në afatin me të shkurtër kohor të prezantojnë pranë zyrës se Prokurimit dhe Prokurimi t’iu ofroj qasje në ofertave që kanë shprehur konkurrencë.

7. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisioni, Prokurimi dhe Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis.

8. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit,
- Prokurimit,
- Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mjedis dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-806/2022	Data: Datum: 25.10.2022	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në nenin 59 paragrafi 1 i Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.18/2011), në nenin 40 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja, shqyrtoj kërkesën e Prokurimit të datës 24.10.2022, për themelimin e Komisionit vlerësues të tenderit për projektin: “Platforma E-Bujku(blerja e sofwarit)”, me numër të jashtëm prokurimi 633-022-9334-1-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-22-064-121, nxjerr:

V E N D I M

